



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 63 datë 30.12.2015

**Për
“MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PA
KUNDËRSHPËRBLIM, TË 100 M², SIPËRFAQE TRUALL SHOQATËS “AKSION
PLUS””**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/II, shkronjave “a” dhe “c”, nenit 32, shkronja “e” dhe nenit 33, pika 4 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 6 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); pikës 1, shkronja “dh” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 31.05.2006 për “Transferimin në pronësi, disa Bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 60, datë 01.02.2006 të Këshillit të Ministrave për “Miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 07.11.2007 “Për dhënie në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 100 m² shoqatës jofitimprurëse “Aksion Plus””; kërkesës së shoqatës “Aksion Plus” me nr.prot. 1238, datë 29.09.2015 (protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr.prot. 13790, datë 29.09.2015) dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim, pa kundërshtëpërblim, të 100 m², sipërfaqe truall, shoqatës “Aksion Plus”, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi, për 15 vite.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI